



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e redaksisë suaj, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 1, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 415 Prot., datë 25.01.2023, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin Nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i cili vjen në zbatim të VKM-së Nr. 495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e Rretheve Gjyqësore dhe kompetencave tokësore të Gjykatave”. Në këtë vendim kuadër përcaktohen tërësitë e parimeve që do të udhëheqin procesin e zbatimit të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave të apelit, duke synuar vijimësinë në drejtimin dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore, administrative dhe atyre mbështetëse nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga data 1 shkurt 2023.

Selia e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është në Tiranë, në adresën Bulevardi “Zhan D’Ark”, (godina aktuale e Gjykatës së Apelit Tiranë). Gjykata ndodhet në qendër të qytetit dhe plotëson standardet e projektimit lidhur me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit ex-parte (pra, ka hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit), dhe hapësira e shërbimit për publikun është e realizuar sipas standardeve.

Për sa i përket pyetjes lidhur me numrin e gjyqtarëve të gjykatave të apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilët për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohen në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe numrin e gjyqtarëve që janë aktualisht të emëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë, pra referuar vendimit nr. 553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të magjistratëve në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm” të KLGj-së, ju pasqyrojmë në tabelën e mëposhtme informacionin e kërkuar:

<i>Nr.</i>	<i>Gjykata</i>	<i>Struktura organizative (dekreti)</i>	<i>Organika në fakt</i>	<i>Efektivisht në detyrë¹</i>
1	Gj.Apelit Durrës	13	6	3
2	Gj.Apelit Gjirokastrë	6	2	2
3	Gj.Apelit Korçë	6	4	2
4	Gj.Apelit Shkodër	10	6	4
5	Gj.Apelit Tiranë	31	20	12
6	Gj.Apelit Vlorë	12	6	2
	TOTALI	78	44	25

Në lidhje me pyetjen tuaj, mbi numrin e dosjeve stok në Gjykatën e Apelit Tiranë janë rreth 20 000 çështje. Treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi Disposition Time) është një prej indikatorëve të efikasitetit të gjykatës dhe shpreh kohën e nevojshme (në ditë) për përfundimin e një çështjeje, nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e saj. Treguesi DT është i rëndësishëm pasi jep mundësinë për të kontrolluar dhënien në kohë të drejtësisë. Kjo është një nga metodologjitë e CEPEJ, ku raporti i numrit të çështjeve të pazgjidhura me numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar, shumëzuar me 365 jep kohën e nevojshme për evadimin e çështjes. Parashikimi i saktë nuk mund të jepet në këtë moment pasi gjykatat janë në fazën e përpunimit të raporteve statistikore dhe përgatitjes së analizave vjetore.

Sa i përket pyetjes mbi numrin e dosjeve që do të vijnë nga gjykatat rajonale të apelit në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm janë rreth 11450 dosje.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

¹ Në numrin e magistratëve (gjyqtar) efektivisht në detyrë, nuk janë përfshirë magistratët (gjyqtar) të cilët aktualisht ushtrojnë funksionin në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm si pjesë e skemës së delegimit